

Data 23.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Materiale ndërtimi Blerje materiale ndërtimi për kanalin
vadtës “Zenelaj-Çepunë”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Llaç
14212400-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 9 903 406.33 (Nëntë milion e nëntëqind tre mijë e katërqind e
gjashtë pikë tridhjetë e tre) lekë pa t.v.sh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gjirokastr** ka hartuar procesverbalin për
argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën
e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM
nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika
5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023,2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo me te vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023,2024,2025) të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika “b”, të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika “b”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo**

më te vogël se 20% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20. % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Ofertusi duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratës përkatëse të noterizuar, automjet të përshtateshëm të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës për furnizimin e mallrave, të pajisur me dokumentacionin ligjor: certifikatë pronësie, kontratat e dhurimit, kontrate bashkepunimi, huapërdorimi apo të qirasë apo sipas rastit si dhe dokumentacionin përkatës: certifikate e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit dhe siguracionin e mjetit në dispozicion, si dhe lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore: dokumentacioni i kërkuar të jetë i vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Nr	Lloji i Makinerise	Pronësia	Sasia
1	Kamion vetshkarkues min 10 ton kap. Mbajtës	Në pronësi ose me qira	1

Përpara publikimit të njoftimit të fitusit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkonë ofertusit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr .162, datë 23.12. 2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6\ç dhe 6\ d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.5 Operatori ekonomike duhet te deklaroj se merr persiper transportin e materialeve sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 3\4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.6 Operatori ekonomik duhet të deklaroj se malli i ofruar përmbush të gjitha specifikimet teknike të kerkuara nga autoriteti kontraktor dhe merr përsipër dorzimin e mallit brenda afatit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.7 Kujdes!

Nr	Kodi buxhetor	Vlera
1	V452AAB	9 111 406.33
2	V424AAB	792 000

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ofertojë sipas vlerave të kodeve buxhetore perkatëse në preventiv në të kundërt përbën kusht për skualifikim pasi autoriteti kontraktor nuk mund të lidhë kontratë me vlera më të larta se ato të cilat ajo disponon.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe sipas Udhezimi nr 23 dt 30.07.2018 per procedurat standartente te programit buxhetor afatmesem te njesive te veteqeverisjes vendore. Per cdo program buxhetor buxheti eshte i ndare dhe i percaktuar me vkb sipas produkteve qe lidhen ne funksionet e atij programi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSI E PROKURIMIT

Aleksandri Pasha

Lorjana Shehu

Rigelsa Alikaj